LIGJ
Nr.9338, datë 16.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9267, DATË 29.7.2004 "PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT, TË RISIGURIMIT DHE NDËRMJETËSIMIT NË SIGURIME DHE RISIGURIME"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në pikën 2 të nenit 6, rreshti i dytë, pas fjalëve "shoqëritë e huaja risiguruese" shtohen fjalët "të miratuara nga Autoriteti,".

Neni 2

Në fund të pikës 2 të nenit 57 shtohen fjalët "duke përfshirë edhe kërkesat e përshtatshmërisë ligjore dhe teknike të pjesëmarrjes influencuese".

Neni 3

Shkronja "a" e pikës 1 të nenit 62 shfuqizohet.

Neni 4

Shkronja "b" e nenit 64 shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4428, datë 16.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu